
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE MBROJTJE DHE SHPËTIM		 Komuna e Istogut Opština Istok
	08 Nr.12/19	Data: 15.02.2019	

Bazuar në neni 7 dhe 8 dhe 10 të Ligjit të Punës nr, 03/L-212 si dhe Njoftimin nga Asociacioni i Komunave të Kosovës i dt. 13.shkurt 2019 për angazhimin e praktikave për futjen e të dhënave në soufter për Zhvillimin e Planit të Veprimit Komunal për Eficientë e Energjisë (MEEAP) bën:

KONKURS PUBLIK

2 (dy) Praktikant në periudhë 2 mujore, në kuadër të projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të komunës në fushën e menaxhimit të energjisë komunale”.

Mbikëqyrësi: Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike , Mbrojtje dhe Shpëtim

Paga: 200 Euro:

Orari i punës: i plotë

Vendi: Komuna Istog

Kohëzgjatja e Emërimit: 2 muaj

Numri i referencës: 08Nr.12/19

Qëllimi i përgjithshëm: Me qëllim të krijimit të një menaxhimi të energjisë në nivelin lokal është e nevojshme të krijohen struktura dhe ngritje të kapaciteteve në të gjitha fushat e menaxhimit të energjisë krejt kjo e mbështetur nga GIZ-I përmes ofrimit të praktikës në 13 komuna përfituese.

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Futjen dhe procesimin e të dhënave në sistemin e menaxhimit të energjisë;
- Mbështetë menaxhimin komunal për energji në aktivitetet e ndërlidhura me procesimin e të dhënave;
- Bashkëpunon me departamentet përgjegjëse në komuna për të siguruar informacion të kërkuar në lidhje me konsumimin e energjisë në ndërtesë dhe ndriçime publike;
- Mbështet menaxhimin për energji në përmbushjen e detyrave të tyre lidhur me zhvillimin e mëtejme të shtetit të menagjimit të energjisë.

Shkollimi i kërkuar: të ketë diplomë pasuniversitare ose të paktën Bachelor në fushën e inxhinierisë apo fushat tjera të cilat ndërlidhen me objektivat e projektit (e preferueshme është fusha e inxhinierisë teknike dhe shkencat kompjuterike).

Dokumentet e kërkuara : Diploma mbi kualifikimin, e preferuar dëshmia mbi përvojën e punës, dokumenti i identifikimit.Njohuri: në kompjuter, shkrim, komunikim dhe aftësi prezantimi, të jetë i mirë i organizuar, të ketë aftësi hulumtuese, të ketë aftësi për të punuar me grup, e preferueshme njohja e gjuhës angleze.

Afati i Konkurimit: Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 15.02.2019 deri më 22.02.2019

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuar dorëzohen personalisht në të njëjtën zyrë.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
Enver Rugova

Enver Rugova